



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
REKTORATI

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORE  
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS  
Nr. 1689/3 Prof.  
Datë: 27.10.2020

**VENDIM**  
Nr. 15, datë 20. 10. 2020

**PËR**  
**"MIRATIMI I INISIATIVËS PËR ORGANIZIMIN E SERISË SË LEKSIONEVE**  
**"FH\_TALKS" NË FAKULTETIN E SHKENCAVE HUMANE".**

Në mbështetje të nenit 83/2 të Statutit të UV-së, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Rektorati në mbledhjen e datës 20. 10. 2020

**Vendosi**

1. Miratimin e iniciativës për organizimin e serisë së leksioneve "FH\_TALKS" në fakultetin e Shkencave Humane.
2. Kjo iniciativë kërkimore synon në tërësi vlerësimin dhe evidentimin e kapaciteteve njerëzore dhe kontributeve të tyre akademike, si dhe rritjen e vizibilitetit të Fakultetit të Shkencave Humane brenda UV-së, në vend e më gjerë.
3. Promovimi i vlerave akademike dhe kapaciteteve intelektuale të brendshme dhe të jashtme me qëllim shkëmbimin e përvojave kërkimore, arsimore e kulturore në disa forma ndërkëmbimi:
  - Mes stafit vendas e të huaj për të thelluar/krijuar bashkëpunime(t).
  - Mes stafit të vetë fakultetit të së njëjtës fushë apo edhe të fushave të ndryshme për të ushqyer qasjet multidisiplinare dhe ndërdisiplinare.
  - Mes stafit të fakulteteve të ndryshme në UV për të promovuar vlerat e brendshme në UV;
  - Mes akademikëve vendas për të nxitur bashkëpunimin në nivel rajonal e kombëtar.

Bashkëlidhur këtij vendimi ndodhet i detajuar materiali shpjegues i iniciativës kërkimore për organizimin e leksioneve "FH\_TALKS" në fakultetin e Shkencave Humane.

**REKTORI**  
Prof. Dr. Roland ZISI

